



---

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**UJESHJELLES KANALIZIME ELBASAN**

**MIRATOHET**  
**ADMINISTRATORI**  
**z.LUAN DERVISHI**

**RELACION TEKNIK**

**OBJEKTI: NDERTIM I RRJETIT TE HIDRANTEVE NE KRASTE**  
**BASHKIA ELBASAN**

**VENDODHJA: KRASTE, RAJONI NR 1, BASHKIA ELBASAN.**

**QELLIMI: Ndertimi i rrjetit te hidranteve per Krasten, per te bere te mundur manaxhimin e zjarreve gjate periudhes se veres.**

**TE DHENAT KRYESORE:**

Hartimi i projektit të objektit: **NDERTIM I RRJETIT TE HIDRANTEVE NE KRASTE BASHKIA ELBASAN**

**PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES:**

- Aktualisht Krasta nuk ka hidrante ne afersi dhe gjate periudhes se veres ka problematika te medha me zjarret. Zjarrfikeset e qytetit e kane shume te veshtire nderhyrjen si pasjoje e terrenit dhe mungeses se pikave te aferta per furnizim te makinave me uje.

Për këto eshte e domosdoshme ndertimi i rrjetit te hidranteve:

- Ndertim i linjes se furnizimit me uje te rrjetit te hidranteve nga depo e Krastes
- Ndertimi i kasetave dhe vendosja e hidranteve ne pikat e kerkuara nga specialistet.
- Ndertimi i stacionit te pompes per furnizimin e hidranteve

- Shtrirja gjeografike.  
Rrjeti i hidranteve ne Kraste, Rajoni nr 1 të Bashkisë Elbasan shtrihen në një sipërfaqe totale prej rreth 50 ha.

### TE DHENAT TOPOGRAFIKE

Rrjeti i hidranteve do të ndërtohet mbi një reliev që shtrihet me një pjerrësi nga 0 – 12 % dhe fillon nga pika e lidhjes me kuot 184m deri ne hidrantin e fundit duke marre parasysh objektin me te larte me kuot 272m.

Skema e furnizimit me ujë do të jetë me ngritje mekanike.

### PERCAKTIMI I KERKESES PER UJE TE ZONES SE RUAJTUR

Percaktojme prurjet karakteristike llogaritese te zones në studim ne baze te dhenave te detyres se projektimit:

- Prurja maximale ditore e qendres se banuar:  
*S*- sipërfaqja e zonës se trajtuar  
*n*- norma orare e perdorimit per uje per nje zhidrant  
*k*- koefiçenti orar i jonjetrajtshmerise se perdorimit te ujit  
*t* – koha ne ore

#### 1. NORMA E LLOGARITJES PER HIDRANTET

Aktualisht ne Krastë nuk ka hidrante, dhe hidrantet që kërkohen të vendosen sipas detyrës së projektimit janë 7 cope  
Norma e llogaritjes per nje hidrante eshte 5.5 l/s per tub plastik PEHD DN 75 mm

#### 2. LLOGARITJA E PRURJES MAKSIMALE

$$Q_{\max/\text{orare}} = 7 \text{ hidrante} \times 6.841/\text{s} = 45.781/\text{s} = \mathbf{164.808 \text{ m}^3 / \text{ore}}$$

Pwr kwtw prurje marrin tubin kryesore me diameter tw jashtwm 160 mm, me material PEHD

### 3. LLOGARITJA E PRURJES MAKSIMALE PER POMPEN

$$Q_{\max/\text{ore}} = 4 \text{ cope hidrante} \times 6.84 \times 3.6 = \underline{\underline{98.5 \text{ m}^3/\text{ore}}}$$

**E marrim prurjen specifike maksimale  $Q = 27.36 \text{ l/sek.}$**

Duke pasur parasysh qe humbjet ne rrjete, e cila arrin ne vleren 17÷20%, percaktojme vleren maksimale te prurjeve llogaritese:

$$Q_{\max/\text{sek}} = 1.2 \times 27.36 = 32.8 \text{ l/s}$$

Me kete prurje zgjedhim tubacionin kryesore DN 160 nga jasht i cili e ka prurjen 40 l/s per  $v=2 \text{ m/s}$

Lartesia përgjegjëse për tu përballuar nga pompa, H i pompes 80-90 m

Do zgjedhim tipin e pompes ne varesi te punës së pompës. Pompa do të jetë centrifugale, rendimenti pompës  $0.8 = \eta$ ,  $H=90 \text{ m}$ , prurja specifike 32.8 l/s

**Në bazë te te dhenave te mesiperme zgjedhim pompe centrifugale 120 kw, me dalje 4”**

### KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Traseja e tubacioneve do te shtrihet mesa te jete e mundur ne rruge publike.

Tubacionet do te perdoren me presion PN 10 atm per rrjetin.

Punimet jane preventivuar sipas detyres se projektimit duke u bazuar cmimet e tregut shqiptar. Preventivi i zbatimit te punimeve pa T.V.SH eshte **8,413,818** leke.

Thellesia e futjes se tubacionit ne toke do te jete nen thellesine 1m per shkak te mbrojtjes se tubacionit nga zjarri, plotesimit te kushteve teknike

Pjeset e dala ne puseta dhe rakorderite do te jene plotesisht metalike .

### HARTOI

**Ing. Julian DOÇI**

**Ing. Lulzime DAMA**

**Ing. Juljan DERVISHI**